



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 677/3 prot.

Tiranë, më 29. 04. 2022

V E N D I M

Nr. 130, datë 29. 06. 2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 71 Regj., datë 28.04.2022, e një grupi ankuesish¹ me aftësi të kufizuara me statusin e të verbërit, përfaqësuar nga Shoqata *“Shpresë për të Verbërit”*, me pretendimin për diskriminim *për shkak të aftësisë së kufizuar*², kundër Bashkisë Durrës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit pala ankuese, Shoqata *“Shpresë për të verbërit”*, shpjegon se, i është drejtuar Bashkisë Durrës me anë të një shkrese, duke i kërkuar informacion sa i përket përfitimeve që personat me statusin e të verbërit, përfitojnë bazuar në ligjin nr. 8098, datë 28.3.1996 *“Për statusin e të verbërit”*, i ndryshuar.

Shoqata *“Shpresë për të verbërit”*, sqaron se Bashkia Durrës me shkresën Nr. 13773/1 prot., datë 27.11.2020, ka informuar se personat me statusin e të verbërit ndër të tjera përfitojnë kompensimin e energjisë elektrike në shumën 2000 lekë për grupin e parë të invaliditetit dhe 1400 lekë për grupin e dytë të invaliditetit. Sipas tyre, Bashkia Durrës nuk i rimbursion personave me statusin e të verbërit, masën e kompensimit të energjisë elektrike mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 14.01.2015 *“Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 KWH”*, në pikën 1/d të saj parashikon se: *“Kompensimin e diferencës së çmimit të energjisë elektrike,*

¹ Znj. H. Ç., znj. L. M., znj. M. Xh., znj. F. B., znj. R. H., z. S. R., z. K. B., z. J. H., znj. N. H. dhe znj. D. P.

² Referuar dokumentacionit të administruar ankuesit janë persona me statusin e të verbërit.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

për efekt të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 Kwh në muaj, për:...d) të verbrit;...". Ndërkohë pala ankuese shpjegon se nga informacioni që ata kanë marrë nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, personat e verbër veç kompensimeve të tjera duhet të përfitojnë edhe kompensimin e diferencës së çmimit të energjisë elektrike, për efekt të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 Kwh në muaj, për të dy grupet e invaliditetit në masën 648 lekë në muaj.

Sa më sipër, pala ankuese pretendon se personat e verbër janë vënë në kushte diskriminuese nga ana e Bashkisë Durrës për shkak të aftësisë së kufizuar, përmes mosdhënies së kompensimit të diferencës së çmimit të energjisë elektrike, për efekt të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 Kwh në muaj.

Në përfundim, pala ankuese kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit të personave të verbër, për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Bashkisë Durrës dhe përfitimin e kompensimit të diferencës së çmimit të energjisë elektrike, për efekt të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 Kwh në muaj, referuar VKM-së Nr. 8, datë 14.01.2015 *"Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 KWH"*.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*⁴, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të *"aftësisë së kufizuar"*, duke përcaktuar se: *"Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër."*

Neni 5, i ligjit nr.10 221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohet gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij

⁴ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: *“1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”*

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”*

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës nr. 677/1 prot., datë 16.05.2022, Komisioneri i është drejtuar Bashkisë Durrës, duke kërkuar informacion sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues.

Në përgjigje të shkresës⁵ së sipërcituar, Bashkia Durrës me shkresën nr. 4439/1 prot., datë 24.05.2022, vuri në dispozicion të Komisionerit informacionin e kërkuar, duke sqaruar ndër të tjera se: *“Bazuar në Udhëzimin nr. 1, datë 02.02.2015 mbi zbatimin e VKM nr. 8, datë 14.01.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt heqjen e fashave të konsumit, të energjisë elektrike deri në 300 Kwh” të tre Ministrive ju sqarojmë se:*

Sipas pikës 3 kreu I të verbërit së bashku me deklaratën sipas aneksit 1, duhet të paraqesin:

- a. Fotokopje të nënshkruar të kartës së identitetit;*
- b. Cerifikatën familjare;*
- c. Fotokopjen e librezës së lëshuar nga SHSSH ose fotokopje të vendimit KMPV;*
- d. Fotokopje të librezës së energjisë elektrike që vërteton që nuk ka detyrime të pa paguara;*

2. Gjithashtu theksojmë se kompesimi i përfitimit VKM nr. 8, datë 14.01.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashave të konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh” po sipas Udhëzimit nr. 1, paragrafi 3 përfitohet vetëm për një kontratë të energjisë elektrike dhe vetëm për një prej kategorive përfituese të përcaktuar në pikën e parë të VKM nr. 8.

3. Përfitues të fashës së kompensimit të energjisë elektrike me statusin e të verbërit janë vetëm 8 persona që kanë plotësuar dokumentacionin sipas Udhëzimit nr. 1, datë 02.02.2015.

Lidhur me pretendimet e Shoqatës “Shpresë për të verbërit”, të cilët pretendojnë se janë diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar dhe përkatësisë në grup me status të veçantë, nga ana e Bashkisë Durrës duke mos u dhënë masën e shtesës së kompensimit për energjinë elektrike është një pretendim që nuk qëndron. Bashkia Durrës çdo pagesë dhe kompensim që qytetarët përfitojnë për shkak të aftësisë së kufizuar apo për shkak të statusve të ndryshëm e kryen konform ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

Personat që pretendojnë që janë diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Bashkisë Durrës dhe përfitimin e kompensimit të diferencës së çmimit të energjisë elektrike, për efekt të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 Kwh në muaj referuar VKM nr. 8, datë 14.01.2015 ‘Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt në heqjen e fashave të konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh’, nuk kanë paraqitur dokumentacionin e nevojshëm për përfitimin e kësaj pagese.”

2. Me anë të e-mail-it datë 31.05.2022, KMD vuri në dispozicion të palës ankuese, shkresën kthim përgjigje të Bashkisë Durrës. Gjithashtu, Komisioneri kërkoi informacion nga ana e Shoqatës “Shpresë për të Verbërit”, nëse personat të cilët ajo ka përfaqësuar pranë KMD-së kanë dorëzuar dokumentat e kërkuar nga legjislacioni për përfitimin e kompensimit të energjisë elektrike sipas VKM-së nr. 8, datë 14.01.2015.

⁵ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 677/2 prot., datë 27.05.2022

Në përgjigje përsa më sipër, Shoqata “Shpresë për të Verbërit” me anë të e-mail-it datë 05.06.2022, sqaroi ndër të tjera se: *“Ashtu siç ju kemi informuar nëpërmjet kërkesës tonë, të gjithë punonjësve të shërbimit social të njësive administrative në Bashkinë e Durrësit, ju paraqiten dokumentat nga të verbërit çdo vit për kompesimin e energjisë elektrike, sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit", i ndryshuar, por nuk marrin parasysh VKM-në për ta shtuar në mënyrë automatike këtë kompesim dhe duke i diskriminuar ata.*

Është një numër i madh i të verbërve që iu është mohuar ajo e drejtë, duke u diskriminuar nga punonjësit e shërbimit social. Kjo është një neglizhencë e punonjesve, sepse nuk i njoftojnë të verbërit për ndryshimet ligjore dhe ana tjetër kur të verbërit iu kanë paraqitur dokumentat provë që nuk e marrin këtë kompesim, punonjësit e shërbimit social nuk marrin masa për rregullimin e pasojave edhe pse ne si shoqatë iu jemi drejtuar disa herë Bashkisë Durrës për këtë problem...Prandaj kërkojmë nga ana juaj të konstatohet si diskriminim që Bashkia Durrësit iu bën personave të verbër. Ky shqetësim nuk është për të verbërit e qarkut të Tiranës as për shumë prej qarqeve të vendit, po vetëm Bashkia e Durrësit edhe disa njësi bashkiake në vend...”.

I. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.

Pretendimi i parë i ankuesve të përfaqësuar nga Shoqata “Shpresë për të Verbërit”, konsiston në faktin se Bashkia Durrës nuk u ka dhënë masën e shtesës së kompensimit për energjinë elektrike në referim të parashikimit të Vendimit nr. 8, datë 14.01.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj”.*

Në referencë të pikës 1, gërma d) të VKM-së së sipërcituar përcaktohet se të verbërit janë përfitues të kompensimit të diferencës së çmimit të energjisë elektrike, për efekt të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 Kwh në muaj.

Sipas pikës 5, të këtij Vendimi përcaktohet gjithashtu se masa e kompensimit, për çdo përfitues, është 648 (gjashtëqind e dyzet e tetë) lekë në muaj dhe efekti financiar të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, miratuar për ndihmën ekonomike.

Në zbatim të VKM-së së sipërcituar, është miratuar Udhëzimi nr. 1, datë 02.02.2015, i Këshillit të Ministrave, *“Mbi zbatimin e vendimit nr. 8, datë 14.01.2015, të Këshillit të Ministrave për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga heqja e fashës deri në 300 Kwh për faturimin e çmimit të energjisë elektrike.”* Në pikat 3 dhe 4, të Udhëzimit të sipërcituar, është përcaktuar shprehimisht se: *“Të verbërit, paralogjikët dhe tetraplegjikët së bashku me deklaratën sipas Aneksit nr. 1 duhet të paraqesin pranë administratorit shoqëror: a) fotokopje të nënshkruar të kartës së identitetit, b)*

fotokopje të librezës së lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose fotokopjen e vendimit të KMCAP/KMPV; c) fotokopje të librezës së energjisë elektrike që vërteton se nuk ka detyrime të papaguara”. 4. Lista e hartuar nga administratori shoqëror miratohet nga Këshilli i Njesisë së Qeverisjes Vendore.”.

Për sa më sipër, pas verifikimeve të kryera nga Bashkia Durrës dhe përgjigjes së vënë në dispozicion nga ana e Shoqatës “Shpresë për të Verbërit”, rezultoi se ankuesit nuk kanë aplikuar dhe nuk kanë përcjellë dokumentacionin e kërkuar sipas Udhëzimit të sipërcituar pranë administratorit shoqëror dhe lista e tyre nuk është miratuar nga Këshilli i Njesisë së Qeverisjes Vendore. Akti nënligjor i sipërcituar parashikon detyrimin e tyre të kryejnë procedurat përkatëse, për të qenë përfitues të shtesës së kompensimit për energjinë elektrike.

Gjithashtu, mbështetur në informacionin e vënë në dispozicion nga ana e Bashkisë Durrës, rezultoi se përfitues të fashës së kompensimit të energjisë elektrike me statusin e të verbërit ishin 8 persona të cilët kishin plotësuar dokumentacionin sipas Udhëzimit nr. 1, datë 02.02.2015 “Mbi zbatimin e VKM nr. 8, datë 14.01.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt heqjen e fashave të konsumit, të energjisë elektrike deri në 300 Kwh”.

Për rrjedhojë, në analizë të sa më sipër, Komisioneri gjykon se, nga ana e Bashkia Durrës nuk ka ekspozuar ankuesit ndaj një qendrimi të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë. Në këtë kuptim dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjektet ankues nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Durrës.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Durrës, për shkak të aftësisë së kufizuar të ankuesve.

Për sa më sipër, KMD i sugjeron ankuesve të ndjekin procedurat e parashikuara në Udhëzimin nr. 1, datë 02.02.2015, të Këshillit të Ministrave, “Mbi zbatimin e vendimit nr. 8, datë 14.01.2015, të Këshillit të Ministrave për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga heqja e fashës deri në 300 Kwh për faturimin e çmimit të energjisë elektrike”, si dhe të depozitojnë dokumentacionin e kërkuar pranë autoriteteve përgjegjëse, për të qenë përfitues të shtesës së kompensimit për energjinë elektrike.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit nga ana e Bashkisë Durrës, të grupi ankuesve⁶ me aftësi të kufizuara me statusin e të verbërit, përfaqësuar nga Shoqata “Shpresë për të Verbërit”, për shkaqet e pretenduara.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Aftësi e kufizuar)
(Fusha: Të mira dhe shërbime)

⁶ Znj. H. Ç., znj. L. M., znj. M. Xh., znj. F. B., znj. R. H., z. S. R., z. K. B., z. J. H., znj. N. H. dhe znj. D. P.